



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 873/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi antarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Halim Halili, nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të të parregullsive dhe mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si të palejueshme ankesat: Anr.873/2013, Anr.874/2013, Anr.876/2013, Anr.877/2013, Anr.878/2013, Anr.879/2013, Anr.880/2013, Anr.881/2013, Anr.882/2013, Anr.883/2013, Anr.884/2013, Anr.885/2013, Anr.886/2013, të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Viti.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar ankesat nëpërmjet Postës së Kosovës të parashtruara në këtë postë me datën 13.11.2013 nga Halim Halili nga subjekti politik PDK dega në Viti, në të cilat pretendon:

- Në ankesën Anr.873/2013, pretendohet se në vendvotimin 2617D/02R ka manipulim të votave nga ana e komisionarëve, ku ka më shumë vota për kandidat se për parti.
- Në ankesën Anr.874/2013, pretendohet se sipas informatave të tyre në fshatin Pozharan vendvotimi 2605D/05R janë manipuluar votat në mes të kandidatëve të PDK-së
- Në ankesën Anr.876/2013, pretendohet se në vendvotimin 2627D/02D ka mospërputhje të votave për parti dhe për kandidat dhe se sipas informatave që kanë votat e numëruara nuk janë shënuar në procesverbal dhe se sipas parashtruesit të ankesës ato u janë shënuar kandidatëve tjerë apo diçka tjetër.
- Në ankesën Anr.877/2013, pretendohet se në vendvotimin 2605D/03R në fshatin Pozharan votat për kandidat për këshilltar janë manipuluar dhe qëllimisht është abuzuar me të.

- Në ankesën Anr.878/2013 të datës, pretendohet se në vendvotimin 2605D/01R në fshatin Pozharan votat e shënuara vetëm për PDK-në ju kanë plotësuar kandidatit nr.4 dhe se votat kandidatët e tjerë nuk janë shënuar si duhet por është manipuluar më të, prandaj kërkon rinumërimin dhe verifikimin e e gjendjes për votat e kandidatëve nga PDK-ja.
- Në ankesën Anr.879/2013, pretendohet se në vendvotimin 2607D/01R në fshatin Sllatinë e Epërme votat për kandidat janë manipuluar dhe nuk janë shënuar në procesverbal, ndërsa kandidates nr.3 i janë prishur votat ndërsa kandidateve të tjerë nuk u janë shënuar votat, prandaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin dhe verifikimin votave.
- Në ankesën Anr.880/2013, pretendohet se në vendvotimin 2604D/03D në fshatin Beguncë votat e kandidatit nr.5 janë manipuluar dhe nuk janë shënuar me saktësi, prandaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin dhe verifikimin votave.
- Në ankesën Anr.881/2013, pretendohet se në vendvotimin 2623D/02D ka manipulim me votat e kandidatëve sepse vota për parti ka më pak se vota për kandidat andaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin dhe verifikimin votave për këshilltar komunal.

Në ankesën Anr.882/2013, pretendohet se në vendvotimin 2601X/05D votat për parti të numëruara janë 29 ndërsa votat për kandidat të shpërndara janë 31 që dëshmon se ka manipulim të votave andaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin dhe verifikimin votave.

Në ankesën Anr.883/2013, pretendohet se në vendvotimin 2607D/02R në fshatin Sllatin e Epërme në Viti, votat për kandidat brenda PDK-së janë manipuluar, pasi që kandidateve të caktuar nr. 5 dhe nr. 2 iu ka bërë edhe një shenjë për ti mos shkruar vota te kandidati, andaj parashtuesi i ankesës kërkon hetimin dhe verifikimin e votave në këtë vendvotim.

- Në ankesën Anr.884/2013, pretendohet se në vendvotimin 2605D/02R është manipuluar me votat e kandidateve të PDK-së pasi që nuk janë shënuar votat e kandidatëve ashtu siç kanë qenë dhe se kandidateve te caktuar iu ka shkruar edhe njëherë fletëvotimi për tu mos u numëruar vota për te, prandaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin dhe verifikimin votave.

Në ankesën Anr.885/2013, pretendohet se në vendvotimin 2610D/02D votat për kandidat për këshilltar të PDK-së janë manipuluar, andaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin e votave dhe verifikimin e gjendjes faktike për votat e kandidateve.

Në ankesën Anr.886/2013, pretendohet se në vendvotimin 2617D/01R në fshatin Smirë votat për kandidatë për këshilltarë nuk janë shënuar siç kanë qenë, prandaj parashtuesi i ankesës kërkon rinumërimin e votave për këshilltaret e PDK-së pasi që dyshon se ka pasur manipulim të rezultateve të votave për kandidat.

Bazuar ne nenin 6.3 të "Rregullave dhe Procedurave" të PZAP-it, në të cilin parashihet se: "Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë". Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshtënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment.

Ankesat në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrahet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së i cili parasheh "Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj".

Në rastin konkret ankesat janë të parashtruar nga Halim Halili, sekretar në degën e Vitisë nga rradhët e subjektit politik PDK, andaj nga kjo del se ankesat në fjalë nuk janë të parashtruar nga personi i autorizuar sipas nenit 102.1 të LZP-së.

Bazuar në arsyet e sipërshtënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet" dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore", vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 873/2013 më datën 15.11.2013

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shafa



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.